



**KËSHILLI I QARKUT SHKODËR**  
**VENDIM**  
**Nr. 14 Datë: 30.12.2020**

**“Për miratimin e Strukturës Organizative të Administratës së Këshillit të Qarkut Shkodër për vitin 2021”**

Këshilli i Qarkut Shkodër, në mbledhjen e Datës 30.12.2020, me propozim të Kryetarit të Këshillit të Qarkut Shkodër, pasi shqyrtoi materialin e përgatitur nga nënpunësit e administratës së Këshillit të Qarkut Shkodër “Për miratimin e Strukturës Organizative të Administratës së Këshillit të Qarkut Shkodër për vitin 2021”, bazuar në: Ligjin Nr.139/2015, Datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, përkatësisht në Nenin 8, pikën dhe Nenin 77, gërma ç); Ligjin Nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil” (i ndryshuar); Ligjin Nr.7961, Datë 12.07.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar); Ligjin Nr. 137/2020, “Për buxhetin e Vitit 2021”; VKM-në Nr.165 Datë 02.03.2016 “Për grupimin e njërive të vetëqeverisjes vendore për efekt pagë dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativ të njërive të vetëqeverisjes vendore”, i ndryshuar; Vendimin Nr. 142, Datë 12.03.2014 “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucione e paravura”, Bazuar në Aktin Normativ Nr.03 datë: 15.03.2020 konkretisht neni 5, “për vendimarrjen e organeve kolegjiale gjatë gjendjes së infeksionit Covid-19”, bazuar në Urdhërin Nr.80 datë 17.11.2020 “për miratimin e rregullave dhe procedurave standarde të punës të harmonizuara, gjatë periudhës së gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga covid-19...si dhe bazuar në Urdhërin nr.633 datë 17.11.2020 “për ndalimin e grumbullimeve me më shumë se 10 persona në vende të mbyllura apo të hapura...”.

Duke marrë shkas nga situata e krijuar nga pandemia Covid-19, mbledhja e Këshillit të Qarkut Shkodër u zhvillua online nëpërmjet platformës Zoom, pas relatimit nga zyra e drejtorisë së financës dhe buxhetit dhe me pas diskutimit nga anëtarët e këshillit u kalua në procesin e votimit ku u Miratua me **14 Vota Pro, 0 Vota Kunder** dhe **0 Vota Abstenim**.

Në përfundim Këshilli i Qarkut Shkodër

**VENDOSI:**

1. Të miratojë Strukturën Organizative të Administratës së Këshillit të Qarkut Shkodër për Vitin 2021 me gjithsej 13 (trembëdhjetë) persona, 3 (tre) të zgjedhur dhe 10 (dhjetë) personel administrativ.
2. Burimet financiare do jenë transferata e pakuzhtëzuar, sipas detajimit të Buxhetit të Vitit 2021.



3. Struktura e pagave për Administratën e Këshillit të Qarkut Shkodër për Vitin 2021, do të jetë sipas tabelës bashkangjitur.
4. Efektet financiare do të fillojnë nga Data 01.01.2021.
5. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes së tij.





**KËSHILLI I QARKUT SHKODËR**

**RELACION**

**"Për miratimin e Strukturës Organizative të Administratës së Këshillit të Qarkut Shkodër për vitin 2021"**

Duke u bazuar në përmbajtjen e Ligjit për Buxhetin e Vitit 2021, përcaktohet se *"Personeli administrativ Këshillit të Qarkut nuk mund të jetë më shumë se 10 veta"*.

Mbështetur sa më sipër, institucioni i Këshillit të Qarkut ka përgatitur dhe paraqet Strukturën Organizative Administratës së Këshillit të Qarkut Shkodër për Vitin 2021 me gjithsej 13 (trembëdhjetë) persona, 3 (tre) zgjedhur dhe 10 (dhjetë) personel administrativ.

Sipas ligjit 152/2013, Neni 2, tek *Fusha e veprimit*, përcaktohet se: *"Ky ligj zbatohet për çdo nëpunës (s'vazhdim "nëpunës civil"), që ushtron një funksion publik në një institucion të administratës shtetërore institucion të pavarur apo njësi të qeverisjes vendore, me përjashtim: a) të zgjedhurve; g) të punonjës administrativ";* pra vet ligji i ndan ushtruesit e veprimtarive përkatëse të administratës shtetërore, institucione të pavarura apo njësi të qeverisjes vendore ndër të tjera në:

- 1) nëpunës civil;
- 2) të zgjedhur dhe
- 3) punonjës administrativ

Pra, bazuar sa më sipër si dhe mbështetur në Ligjin Nr.139/2015, Datë 17.12.2015 *"Për vetëqeverisjen vendore përkatësisht në Nenin 77, gërma ç);* ku përcaktohet se: Këshilli i Qarkut ushtron këto kompetenca dhe detyra: *"mirat strukturën, organikën dhe kategoritë/klasat e pagave për çdo pozicion të shërbimit civil dhe rregulloret bazë administratës së qarkut, të njësi të institucioneve buxhetore në varësi të qarkut, si dhe numrin e personelit të ty kërkesat për kualifikim, pagat dhe mënyrat e shpërbërimit të punonjësve e të personave të tjerë, të zgjedhur ose të emëru në përputhje me legjislacionin në fuqi"* – Institucioni i Këshillit të Qarkut Shkodër paraqet Strukturën Organizative Administratës së tij për Vitin 2021 me 3 (tre) të zgjedhur dhe 10 (dhjetë) personel administrativ, gjithsej (trembëdhjetë) persona.

Bazuar në funksionet që kryen administrata e Këshillit të Qarkut Shkodër, vlerësohet që të vazhdojë struktura vitit 2020 me dy drejtori.

Bashkëngjitur këtij Vendimi dhe Relacioni do të gjeni:

Strukturën e pagave për Administratën e Këshillit të Qarkut Shkodër për Vitin 2021.

